



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 34

Datë: 24. 11. 2022. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Arianit Elshani, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.29 dhe 30/2022**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 4. Raport për Aktivitetet e ZRCKFSP**
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së SKQZ-së, për ri denstinimin e buxhetit për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan,
- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan,

Këshilli për Çështje Ligjore

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Shtime

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Arianit Elshani, Krvesues i mbledhjes së KQZ-së:

Arianit Elshani: Përhëndetje, në mungesë të kryetarit jam i autorizuar që unë ta kryesoj këtë mbledhje! Prezent jemi tetë anëtarë, dhe me z. Kurteshi jemi të lidhur online, domethënë jemi nëntë anëtarë...

Në vazhdim, z. Elshani paraqiti agjendën e mbledhjes dhe pastaj, anëtarët miratuan rendin e ditës pa ndonjë ndërhyrje, propozim etj.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ pas vlerësimit, miratuan procesverbalet e mbledhjeve të KQZ-së nr.29, dhe 30/2022.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, kryeshef i Sekretariatit tha se raporti i sotëm, prmbanë kryesisht informacione lidhur me zgjedhjet e reja. Sekretariati, në bazë të vendimit nga Presidentja e Republikës së Kosovës të datës 14.11.2022, për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe

Zveçan, ka filluar përgatitjet intensive për organizimin e zgjedhjeve. Në këtë aspekt, këto zgjedhje që do të mbahen më 18 dhjetor 2022, KQZ në bazë të ligjeve në fuqi, e krijojnë dhe mirëmban Listën e Votuesve. Në mënyrë që Lista e Votuesve të jetë sa më e saktë dhe e azhurnuar dhe gjithashtu duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, tha z. Ahmetaj, sipas nenit 7.7, Gjykata Kompetente duhet të dorëzojë të dhënat në KQZ për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësorë të formës së prerë. Po ashtu duke u bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 2/ 2013 për Krijimin, Konfirmimin dhe Kundërshtimin e Listës së Votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës që të ofrojë listën e qytetarëve me të drejtë vote të cilëve, u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësorë të formës së prerë. Dhe, mesa datave 24 - 29 nëntor 2022, kemi kërkuar nga KGJ që të na i sigurojë të dhënat personale të personave/qytetarëve që, u është marrë zotësia e veprimit me vendim të prerë gjyqësor nga Gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës.

Periudha e aplikimit/regjistrimit për votim përmes postës, do të fillojë më datën 26 nëntor - 30 nëntor 2022 vetëm për qytetarët që jetojnë jashtë vendit dhe që kanë dëshmi të vendbanimit në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut. Sekretariati, tani është edhe në fazën e zhvillimit të procedurave për furnizime dhe shërbime. Ndër aktivitetet më kryesore të prokurimit, janë shtypja e fletëvotimeve, shtypja e Listës së Votuesve, shtypja e Formularëve Zgjedhor si dhe Informimi Publik.

Po ashtu, z. Ahmetaj i informoi anëtarët e KQZ-së se Sekretariati është në fazën e rekrutimit të stafit jo permanent. Për shkak të urgjencës së punëve, tetë (8) persona janë angazhuar në zyrë, (2) staf në burime njerëzore, dhe një (1) në përkthyes shqip-serbisht. Angazhimi i stafit tjetër, do të bëhet përmes procedurave të shkurtuara të rekrutimit, të cilat janë akoma në fazën e vlerësimit dhe poentimit.

Nga raporti i tij, Ahmetaj tha se më 9 nëntor 2022, janë paraqitur edhe dorëheqjet nga Zyrtarët Komunal të Zgjedhjeve në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Lidhur me këtë, është njoftuar KQZ. Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 66.5 nën paragrafi (f) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 14.11.2022, Nr.09/1358-2022, për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, si dhe bazuar në Deklaratën e Dorëheqjes së ZLKZ në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, me

datë 22 nëntor kam caktuar për kryerjen e detyrave shtesë: z Bajram Hajdari, Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në komunën e Mitrovicës së Jugut, caktohet ushtrues detyre që t'i kryejë njëkohësisht punët dhe detyrat shtesë edhe të Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në komunën e Mitrovicës së Veriut, nga data 22 nëntor 2022; Betim Xhema, Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në komunën e Vushtrrisë, caktohet ushtrues detyre që t'i kryejë njëkohësisht punët dhe detyrat shtesë edhe të Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në komunën e Leposaviqit, nga data 22 nëntor 2022; Burim Jonuzi, Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në komunën e Gllogocit, caktohet ushtrues detyre që t'i kryejë njëkohësisht punët dhe detyrat shtesë edhe të Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në komunën e Zveçanit, nga data 22 nëntor 2022; Fisnik Polaci, Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në komunën e Skenderaj, caktohet ushtrues detyre që t'i kryejë njëkohësisht punët dhe detyrat shtesë edhe të Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në komunën e Zubin Potokut, nga data 22 nëntor 2022. Sekretariati për shkaqe sigurie akoma nuk i ka në dispozicion zyrat ne të cilat kanë qenë të vendosur Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve. Janë bërë përpjekje për shfrytëzimin e zyrave mirëpo, deri me tani ka qenë e pamundur që zyrat të shfrytëzohen. Aktualisht, ZLKZ të caktuar si ushtrues detyre do të veprojnë nga lokacioni i tyre dhe subjektet janë njoftuar për personin zyrtar për që do ta ushtrojë detyrën në komunat përkatëse. Kemi kërkuar masa sigurie për zyrtarët e Sekretariatit nga Policia e Kosovës. Policia e Kosovës dhe organet tjera të sigurisë, janë në fazën e vlerësimit të rrezikut në komunat e lartëcekura dhe përderisa nuk kemi konfirmin për ofrimin e sigurisë, fushë veprimtaria e ZLKZ-ve do të ushtrohet nga zyrat e tyre.

Alim Rama, tha se në mbledhjen nr. 31 ka paraqitur disa vërejtje që kanë të bëjnë me afatet, pastaj në lidhje me planifikimet. Ende bëhet rekrutimi i stafit, por a është rekrutimi në proporcion me numrin e votuesve në terren, sepse tash kemi vetëm rreth 45 000 votues që i bje, 2.5 % nga numri total që ka përmbajtur lista e votuesve në zgjedhjet e kaluara. Tash, me planifikimin fillestar, e kur flasim për punën - volumi i punës është i vogël në krahasim me numrin e stafit të angazhuar në zyre... Ky staf, po më duket shumë i lartë në Sekretariat ! Se kam fjalën për stafin që lidhet me fokusin e zgjedhjeve në komuna, por vetëm brenda në sekretariat...

Në lidhje me qasjen për plotësimin e KKZ-ve, a janë kontaktuar organizatat joqeveritare si në zgjedhjet e kaluara për plotësimin e KKZ-ve?, pyeti z. Rama. Në të katër komunat, kemi pasur plotësim të KKZ-ve me organizata jo qeveritare...

Sami Kurteshi: (nga këtu, sepse teknikisht nuk është i incizuar i gjithë diskutimi) ...në ato komunat që janë të entitetit serb, për arsye se mund të jetë ndonjë refuzim, frikë e tyre dhe me tregue se ne e kemi pushtetin faktik atje...Dhe, a është bërë përpjekje me shkure në apo zyre që janë mbyllë, apo njëherë me u rregullua çështja e sigurisë...?

Ilir Gashi, pyeti lidhur me kontaktet me institucionet e tjera për mbarëvajtjen e procesit, pra me MPB-në, me Ministrinë e Arsimit. Pra, duhet shtuar kontaktin prandaj, ne ende e kemi të paqartë por, cili është kontakti juaj që të na siguroni ju lidhur me mbarëvajtjen e procesit ? A ju ka kontaktuar juve ndonjë institucion ?

Čemailj Kurtiši: Unë, vetëm dua të theksoj se shumë duhet të mësojmë kur është në pyetje siguria, sepse duhet të kujtoj këtu dhe nuk duhet të harrojmë se në vitin 2010 kanë pësuar dy veta, Shefko Sallkoviç dhe Edin Islamoviç, i cili u plagos rënd, ndërsa Shefko vdiq në vend. Duhet të arrihen kushtet e sigurisë, tani dhe më tutje. Nuk duhet të ketë vakum, krejt procesi zgjedhor nuk vlen sa në viktimë, prandaj këtu duhet të fokusohemi: te siguria...

Ibrahim Selmanaj: Duke shprehur për më të mirën, por ne duhet ta pranojmë realitetin se atë pjesë të territorit ne, nuk e kontrollojmë! Ne kemi problem edhe me mbërri në pikat ku i organizojmë zgjedhjet. Pjesa teknike është më pak me rëndësi, por me rëndësi është ana praktike. Sekretariati, duhet ta kryej punën, por duhet shtuar domosdo kontakti me institucionet sepse, se ne duhet të jemi të vetëdijshëm se ky proces nuk është aspak i lehtë...

Gordana Llaban: Unë, vetëm desha të them se, zyrtarët që janë autorizuar në KKZ është shumë me rëndësi që të flasin gjuhën serbe sepse, shumica e qytetarëve atje flasin serbisht. Nëse dikush vjen, dhe dëshiron të votojë, mund të hasë në problem për shkak të gjuhës dhe mendoj se këta zyrtarë të angazhuar, së paku duhet të kishin njohuri komunikimi! Problemi i sigurisë, po, është kryesori, materiali ku do të vendoset etj., nëse nuk ka siguri unë nuk e di si mund të mbahen zgjedhjet...

Arianit Elshani, tha se ajo çka është në përgjegjësinë tonë ne jemi duke e zbatuar, kurse çështjet e sigurisë, padyshim që janë pjesë e angazhimit të institucioneve të caktuara...

Burim Ahmetaj, tha se stafi i marrë është kërkesë e njërive të caktuara, dhe ne kemi marrë për bazë praktikën e kalaurës, zgjedhjet e vitit 2019. Por, pavarësisht kësaj, ne jemi në fund të vitit dhe

kemi edhe shumë punë tjera, prandaj kemi llogaritur që na duhet stafi...Kemi volum të madh të punëve...

Sa u përket ftesa të nominimeve të KKZ-ve, ne kemi dërguar te të gjitha subjektet, por edhe te organizatat civile. Sa u përket çështjeve të sigurisë, deri më tani kemi mbajtur 3 takime me policinë, dhe ata janë në fazën e vlerësimit të rrethanave dhe situatës. Nuk kemi ende ndonjë raport, as udhëzim...

Ilir Gashi, tha se kërkesën e Gordanes duhet me pas parasysh, sepse ka njerëz që nuk din me komunikue, ose me siguria staf përkthyes, ose personat që dërgohen duhet me ditë me komunikue...

Sami Hamiti, tha se e përkrahi Ilirin që duhet një bashkëpunim i ngushtë me presidencën, kryeministrinë, ministrinë e brendshme sepse, ne asnjë hap nuk mund ta bëjmë pa ta. Por, ajo që kërkohet me ditë gjuhën serbe apo njërën prej gjuhëve zyrtare, ne duhet ta dim – ashtu si edhe zonja Gordana se nëse komuniteti serb nuk merr pjesë në zgjedhje cila është arsyeja që kërkohet me ditë gjuhen tjetër...Është kruciale që KQZ të ketë bashkëpunim me institucionet, sepse ne organizojmë zgjedhjet por ne nuk mund ta marrim barrën e sigurisë...

3. Raport për Aktivitetet e ZRCKFSP

Vesa Xharra, ushtruese e detyrës së drejtorit, tha në fillim të raportit të saj se Zyra, pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut, në përputhje me Planin Operacional, Zyra ka filluar implementimin e afateve prej datës 15 nëntor 2022. Prej afateve të para që kanë filluar të rrjedhin ishte ai për kufizimin e shpenzimeve të fushatës. Me rekomandimin e Zyrës, KQZ më 18 nëntor ka marrë vendim për vendosjen e limitit të sipërm për shpenzimet e fushatës që është kalkuluar në përputhje me numrin e banorëve në komunat në të cilat po organizohen zgjedhjet. Limitet e vendosura do të shërbejnë si bazë për raportimin dhe kontrollimin financiar të deklarimeve financiare të fushatës për subjektet politike që certifikohen për të marrë pjesë në këto zgjedhje. Ndërkohë, afati i fundit për deklarimin e pjesëmarrjes në zgjedhje përmes koalicionit ishte data 17 nëntor 2022. Gjatë kësaj periudhe Zyra nuk ka pranuar asnjë deklaram për pjesëmarrje në zgjedhje përmes koalicionit.

Një afat tjetër, tha drejtoresha Xharra, i cili ka përfunduar më 19 nëntor ishte afati për deklarim për mos pjesëmarrje në zgjedhje. Gjatë kësaj kohe, Zyra ka pranuar katërbëdhjetë (14) parti politike të cilat, janë deklaruar për mos pjesëmarrje janë si në vazhdim: Srpska Lista, Demokratska Stanka Vatan, Fjala, Social Demokratska Unija, Kosovaki Nevi Romani Partija, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Demokratska Stranka Bosnjaka, Iniciativa Balli, Partia Demokratike e Unitetit, Forca e Diasporës, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Kosova Demokratik Türk Partisi, Lëvizja për Bashkeveprim dhe Partia e Drejtësisë.

Sa i përket afatit për certifikim, pas shtyrjes së afatit për aplikim për certifikim prej 21 në 25 nëntor, zyra, tha z. Xharra, vazhdon të pres aplikimet nga subjektet politike. Ajo, i ka njoftuar anëtarët e KQZ-së në këtë mbledhje se, deri më 24 nëntor 2022, në Zyrë kanë aplikuar për certifikim tri (3) subjekte politike me gjithsej gjashtë (6) kandidatë të ndarë në komuna si në vijim: Për komunën e Mitrovicës së Veriut: Iniciativa Qytetare Mitrovica me kandidat Betim Osmani, Partia Demokratike e Kosovës me kandidat Taulant Kelmendi, Për komunën e Leposaviqit: 1. Partia Demokratike e Kosovës me kandidate Albulena Behluli Hetemi. 2. Partija Kosovskih Srba me kandidat Aleksandar Jablanoviq. 3. Për komunën e Zubin Potokut: 1. Partia Demokratike e Kosovës me kandidat Izmir Zeqiri. Për komunën e Zveçanit: 1. Partia Demokratike e Kosovës me kandidat Ilir Peci.

Në fund, Xharra tha se afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare si dhe mediave, mbetet i hapur deri më 12 dhjetor 2022. Deri më tani, zyra nuk ka pranuar asnjë aplikim për akreditim të vëzhguesve, ka thënë Xharra.

Ilir Gashi: Shihet që 14 subjekte janë deklaruar që nuk marrin pjesë në zgjedhje. A do të thotë që të njëjtit nuk mund të rikthehen? Pastaj, kërkesa në Këshill Gjyqësorë për verifikimin e kandidatëve, ndërsa ne presim edhe shpalljen e zgjedhjeve për kuvende komunale ku do të kemi edhe më shumë kandidat; A e keni kontaktuar këshillin gjyqësorë se, a bënë pjesë kjo çështje e verifikimit të kandidatëve në çështjet esenciale ku ata mund ti trajtojnë gjatë kësaj periudhe, apo do mbesim peng duke mos e ditur se çfarë kandidatë do të certifikojmë...?

Alim Rama: Pyetja jemi ka qenë: A është konsideru “proporcionaliteti” i angazhimit të stafit...? E jo krahasimi me vitin “2019” se, unë as që kam qenë anëtar i KQZ...Se, në momentin e marrjes së stafit, kanë qenë të shpallura vetëm zgjedhjet për kryetar të komunave...? Pra, realisht është një përqindje e vogël, krahasuar me stafin e angazhuar...Të gjitha këto planifikime, duhet me qenë

proporcionale ! Urgjenca për me angzhue këtë staf për një kohë të shkurtër vetëm për pranimin e aplikimeve, unë ende mendoj që nuk ka qenë ë nevojshme dhe ka qen e paarsyeshme...

Vesa Xharra: Në lidhje me pyetjen e z. Gashi...! Jo, nuk i kemi kontaktuar institucionet. E kemi parasysh që i kemi 8 institucione që duhet të bëhet verifikimi i kandidatëve, mirëpo nuk kemi kontaktuar ende. Ata, janë të obliguar me iu përgjigjur kësaj, por unë nuk e di si kemi me pas ende verifikimin...

Sami Hamiti: Po shoh që, edhe KDTP-ja nuk po marrka pjesë ! A e dinë që dy herë mos me marrë pjesë, përfshi edhe Lista Serbska fshihen nga regjistri...? Mu tërheqë nuk është mirë...

Burim Ahmetaj, tha se jemi afër shpalljes edhe të zgjedhjeve për asamble. Por, nuk ka problem sepse, ne kemi bërë disa planifikime... Mund të ketë problem te aplikimi dhe certifikimi i kandidatëve...

7. **Raport i Këshillave të KOZ-së:**

Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së SKOZ-së, për ri destinimin e buxhetit për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan:

Gordana Llaban: Sot, ne jemi takuar dhe kemi shqyrtuar kërkesën e Sekretariatit për ri destinimin e buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komuna. Bëhet fjalë për 17 840 euro që kanë mbetur nga një projekt. Sekretariati, ka kërkuar që të merren ato mjete dhe të përdoren për procesin e këtyre zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Ne, mendojmë në këshill se këto mjete mund të merren, dhe ne rekomandojmë këtë kërkesë të aprovohet...

Me 10 vota për, aprovohet.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan:

Gordana Llaban: Kemi shqyrtuar edhe planin e buxhetit për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për këto zgjedhje të jashtëzakonshme, si për anëtarët e KQZ-së dhe si për Sekretariatit. Kjo, deri në 40 orë, ky është kufiri...

Miratohet, me 10 vota.

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Shtime:

Sami Hamiti, tha se në mbledhjen e këshillit është shqyrtuar kërkesa e kryesuesit të kuvendit komunal në Shtime për një zëvendësim.

Heroina Selmani nga subjekti politik “Vetëvendosje!” ka dhënë dorëheqje për arsye personale. Ne e kemi shqyrtuar dokumentacionin, dhe e njëjta zëvendësohet nga Zejnie Veliu. Kriteret ligjore, janë të përmbushura dhe ne rekomandojmë për zëvendësim.

Me 10 vota për, zëvendësohet.

3. Të ndryshme !

Alim Rama, pyeti se ku ndodhet procesi i zëvendësimit të këshilltarëve komunal në dy komuna, në Mitrovicë të veriut dhe në Zubinpotok ?

Burim Ahmetaj, tha se secili asamblistë që zëvendësohet duhet ta ketë një deklaratë që zëvendësohet. Këto shkresa, i kemi dërguar te subjektet politike dhe ne nuk kemi marrë përgjigje se a e pranojnë mandatin apo jo...! Nuk kemi marrë ende përgjigje...

Arianit Elshani, informoi se “nesër” KOZ do të takohet lidhur me KKZ-të dhe çështjeve tjera që mund të dalin gjatë kohës deri nesër...